

**Myotis bechsteinii - Lakuriq nate i Bechsteini-it**

Lakuriq nate i Bechsteini-it është një lloj i rrallë në Evropë dhe në Shqipëri. Ai duket se është i lidhur ngushtë me pyjet e rritura fletore, veçanërisht dushkajat dhe ahishtat, me një nën pyll të zhvilluar mirë dhe shumë drurë të vjetër e të mëdhenj. Vend strehimet e femrave në lindje janë përgjithësisht në të çarat e drurëve apo vrimat e qukapikëve. Ai bie në gjumë letargjik në të çarat e drurëve si dhe në vende të nëndheshme. Kolonitë mund të përdorin 30-50 të çara drurësh përgjatë vitit.

Ky është një lakuriq me trup mesatar (hapja e krahëve 250-300 mm) me veshë dukshëm shumë të gjatë që shkojnë përtej hundës kur palosen përpara. Ai përdor thirrje të qeta ekolokacioni (lakuriq pëshpëritës) për të gjuajtur në një mjedis të larmishëm dhe zgjedh një gamë jorruazorësh që i kap nga gjethet apo në toke.



P. Kanuch

**Nyctalus noctula - Noktulë**

Ky lloj lakuriqi është shumë i përhapur në Evropë, edhe pse mungon në pjesën veriore dhe është më pak i zakonshëm në Mesdhe. Ai është kryesisht një lakuriq drurësh, që gjatë verës strehohet shpesh nëpër të çarat e drurëve, veçanërisht në vrimat e qukapikëve. Ai bie në letargji në të çarat e drurëve, të shkëmbinjve apo të çarat në godina të larta veçanërisht në Evropën qendrore dhe lindore, ku grumbullohen një numër i madh individësh. Zakonisht strehohet në vende që janë mbi 3 m lartësi dhe gjuan mbi kurorat e drurëve dhe në një larmi çeltirash.

Ky lloj lakuriqi është trup madh me një gëzof të dallueshëm të yndyrshëm, kafe në të kuqërremtë, edhe pse në kafe pa shkëlqim pas ndërrimit të qimeve apo tek të vegjlit. Veshët, hunda dhe membrana e krahëve janë në kafe të errët. Ai ka një aromë të forte e të dallueshme myshku. Ai fluturon shpejt me krahët e gjatë e të ngushtë dhe ka një thirrje të fortë ekolokacioni të cilën shumica e njerëzve e dëgjojnë.



NABU

**Barbastella barbastellus - Barbastelë**

Ky lloj lakuriqi është gjerësisht i përhapur në Evropë, por zona e tij e përhapjes është mjaft e fragmentuar dhe konsiderohet i rrallë pothuajse kudo. Ai gjendet zakonisht në pyjet e dushkut apo të ahut.

Edhe pse grupet e femrave në lindje përdorin ndonjëherë drurët apo rrallë edhe godinat, ata zakonisht strehohen nën lëvoret e pemëve apo në zgavrat që gjejnë në drurët e tharë, prandaj drurët e tharë në këmbë përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm të pyllit për këtë lloj lakuriqi.

Ky lakuriq shpesh lëviz midis vendstrehimeve, prandaj për të ruajtur koloninë, kërkohet menaxhimi i gjithë pjesëve të pyllit dhe jo vetëm ruajtja e drurëve të veçantë. Rrjedhimisht duhet mbajtur një numër i madh drurësh të tharë për të garantuar mbijetesën e këtij lloji mjaft të ndjeshëm.

Me një trup mesatar (gjatësia e parakrahut 35-43 mm), ai karakterizohet nga veshët e vegjël trekëndorë që bashkohen në majë të kokës, duke e bërë të pagabueshme njohjen e tij. Kur fluturon në vende të hapura apo në skajet e vegjetacionit, ai alternon midis dy lloj thirrjeve ekolokalizuese. Ai ushqehet në një larmi habitatesh (veçanërisht pyje apo lugina lumenjsh me drurë) dhe dieta e tij dominohet nga fluturat e natës.



G. Jones



L. Cistrone



L. Cistrone

Sekretariati i UNEP/EUROBATS  
United Nations Campus  
Platz der Vereinten Nationen 1  
53113 Bonn, Germany  
Tel: +49 228 815-2431  
Fax: +49 228 815-2445  
E-mail: eurobats@eurobats.org  
Website: www.eurobats.org

Teksti: Tony Mitchell-Jones, IWG on Bats and Forestry  
Barbastelë: Danilo Russo  
Fotot në faqen e parë: Luca Cistrone (pyjet), NABU (Plecotus auritus)  
Përditësimi dhe përshtatja në shqip : Philippe Théou, Genti Kromidha  
Dizajni: Uwe Vaartjes

© UNEP/EUROBATS

Botimi në shqip mundësohet nga projekti "Forcimi i kapaciteteve kombëtare për ruajtjen e natyrës dhe përgatitja për Natura 2000"



**LAKURIQËT  
E NATES  
DHE PYJET**



## LAKURIQËT E NATES

Lakuriqët e natës janë të vetmit gjitarë që realisht fluturojnë. Krahët e tyre prej lëkure shtrihen përgjatë gishtave të zgjatur. Ata janë kafshë me gjak të ngrohtë dhe pjellin këlyshë të cilët i ushqejnë me qumësht gjiri.



L. Cistrone

Në mbarë botën ekzistojnë më shumë se 1200 lloje lakuriqësh dhe ata gjenden që nga tropiku deri në deri

në skaj të rajoneve polare. Të gjitha llojet insektengrënëse Evropiane, pjese e kësaj fletëpalosjeje, ushqehen me

insekte e merimanga, që i kapin në ajër apo nëpër gjethe apo në tokë. Lakuriqët shohin shumë mirë por ata gjithashtu përdorin një sistem të sofistikuar ekolokacioni për tu orientuar dhe për të gjetur pre në errësirë. Ky sistem, nëpërmjet të cilit lakuriqët lëshojnë një tingull me frekuence të lartë dhe analizojnë jehonën e kthyer, është kaq i ndjeshëm sa ata mund të kapin insekte të vogla në ajër. Edhe pse me gjak të ngrohtë si njerëzit, lakuriqët e kontrollojnë më së miri temperaturën e trupit të tyre dhe mund të lejojnë që temperatura të bjerë ndjeshëm duke u bërë të ftohtë e të palëvizshëm për të kursyer energji. Në vendet me klimë të ftohtë, shumë lloje bien në letargji për një periudhe të gjatë kur nuk ka ushqim.



P. Boyre

Lakuriqët e natës kanë një jetë shoqërore komplekse dhe shumica jetojnë në koloni për të paktën një pjesë të vitit. Përgjithësisht ata formojnë koloni gjatë periudhës së shumimit, kur femrat mblidhen bashke për të lindur të vegjlit. Sipas llojeve, kolonitë variojnë në madhësi nga disa individë në disa mijëra, ku kolonitë më të mëdha gjenden në shpella apo vende të ngjashme. Në periudha të tjera të vitit, lakuriqët mund të jetojnë të vetmuar apo në grupe të vogla. Gjatë periudhës së shumimit lakuriqët kërkojnë vende të ngrohta apo mblidhen në tufa të mëdha për të ngrohur njeri tjetrin. Në periudha të tjera ata kërkojnë vende më të freskëta ku mund të lejojnë që temperatura e trupit të tyre të ulet dhe të kursejnë energji.



P. Kanuch

Lakuriqët mund të strehohen në një larmi vendesh por më të rëndësishmet janë drurët, godinat apo vendet e nëndheshme si shpellat apo minierat e braktisura. Disa lloje përdorin kryesisht drurët, të tjera preferojnë vendet e nëndheshme dhe disa të tjera lëvizin midis drurëve dhe vendeve të nëndheshme në varësi të klimës dhe stinëve. Shumë prej tyre tashmë strehohen në godina pasi këto sigurojnë kushte të ngjashme si me drurët dhe me vendet e nëndheshme.

Lakuriqët që strehohen nëpër drurë shfrytëzojnë të çarat, zgavrat apo vrimat e kukapikeve si dhe zonat me lëvore të carë për tu strehuar. Disa lloje pëlqejnë të ngjishen në të çara të vogla ndërsa të tjera preferojnë të grumbullohen në zgavra si ato të hapura nga kukapiket. Drurët me këto lloj karakteristikash janë shumë të rëndësishëm në çdo lloj pylli. Shumica e lakuriqeve që strehohen nëpër drurë lëvizin midis disa drurëve gjatë një periudhe kohe prandaj ata duhet të kenë në dispozicion, në një sipërfaqe të vogël, një numër drurësh me vende të përshtatshme për të jetuar si dhe një mundësi të vazhdueshme për të gjetur vende të reja pasi drurët e vjetër kalben apo hiqen.



L. Cistrone

Të gjithë lakuriqët e Evropës janë kafshë nate, zakonisht dalin nga strofkat e tyre në muzg dhe kthehen në agim apo më herët. Ata gjuajnë sa herë që ka një përqendrim të bollshëm të insekteve që ata preferojnë, pasi lloje të ndryshme janë të specializuara në lloje të ndryshme insektesh apo mënyra të ndryshme gjuetie. Për shembull, disa lloje specializohen në kapjen e fluturave të natës që pushojnë mbi gjethe, të tjerë gjuajnë insekte të vogla në vende të hapura apo mbi ujë. Disa gjuajnë edhe në fluturim, duke u varur nëpër degë derisa pikasin insektin e duhur. Shumica e lakuriqëve gjuajnë brenda pak kilometrave nga vendi i strehimit prandaj pyjet duhet të sigurojnë si vend strehimi dhe vend gjuetie brenda kësaj distance. Për më tepër, shumë lloje të vegjël lakuriqësh evitojnë fluturimin në vende të hapura, prandaj lidhjet e përshtatshme midis zonave pyjore që i lejojnë ata të lëvizin midis tyre mund të jenë shumë të rëndësishme. Pak lloje shtegtojnë në distanca të largëta në pranverë dhe vjeshtë dhe kanë nevojë për vende të përshtatshme pushimi nëpër pyje gjatë shtegtimt.

## MBROJTJA

Të gjitha llojet e lakuriqëve të natës janë ligjërish të mbrojtura në Shqipëri, si rezultat i integritetit të Direktivave Evropiane të Habitave dhe Llojeve në legjisllacionin kombëtar (Ligji Nr. 68/2014).

## LAKURIQËT E NATES DHE PYJET

Pyjet e çdo lloji, duke filluar nga pyjet mesdhetare të Evropës jugore deri te pyjet halore boreale të Evropës veriore, përdoren nga lakuriqët e natës. Në shumicën e rasteve, lakuriqët kërkojnë karakteristika të veçanta si pellgje apo rrjedha ujore, çeltira apo zona skajore ku insektet janë më të shumtë. Se cilat karakteristika janë më të rëndësishme kjo varet nga tipi i pyllit dhe llojet e lakuriqëve që gjenden në të.



A. T. Bashita

Përhapja, diversiteti dhe dendësia e lakuriqeve në pyjet e menaxhuar mund të ndikohet nga konkurrenca për vende të kufizuara strehimi. Menaxhimi i pyjeve për të mbajtur apo përmirësuar popullatat e lakuriqëve të natës kërkon një njohje sa më të mirë të llojeve të lakuriqeve që gjenden në këtë pyll dhe të nevojave të tyre për strehim, ushqim dhe lëvizje. Gjithashtu, është e rëndësishme të kuptohen ndikimet e menaxhimit të pyllit tek lakuriqët e natës.

Larmia e madhe e tipeve të pyjeve në Evropë, së bashku me larminë e praktikave të menaxhimit dhe strukturave administrative e rregullatore, kërkon që këshillat e detajuara për menaxhimin e pyjeve dhe lakuriqëve të natës të hartohen në nivel lokal. Megjithatë, disa parime të rëndësishme mund të zbatohen në të gjithë Evropën dhe mund të përbëjnë bazën e hartimit të këshillave lokale. Ne rekomandojmë që praktikat e mira të renditura më poshtë të përdoren si bazë për zhvillimin e udhëzimeve kombëtare që marrin parasysh tipet e pyjeve dhe praktikat pyjore lokale.

## UDHEZUES PËR PRAKTIKAT E MIRA PËR NJË PYLTARI MIQESORË ME LAKURIQËT NË EVROPE

### PLANIFIKIMI I PEIZAZHIT

- Një strategji për të gjithë peizazhin ndihmon edhe lakuriqët e natës. Për të pasur mundësi të kombinojmë ruajtjen me prodhimin e lëndës drusore është e rëndësishme të bëhen gjërat e duhura në vendin e duhur. Përfshini këshillat e një specialisti të lakuriqëve të natës në fazat fillestare të planifikimit..

- Disa lloje lakuriqësh ndikohen nga fragmentimi: evitoni krijimin e parcelave të izoluar.

- Korridoret përgjatë rrjedhjeve ujore përdoren nga lakuriqët si vend ushqimi dhe lëvizjeje. Brezat e shkurreve apo drurëve që lidhin pyjet apo zonat me drurë i ndihmojnë lakuriqët.

### OPERACIONET PYJORE

- Ruani dhe zgjeroni zonat e strehimit duke ruajtur drurët e tharë, drurët e mëdhenj e të vjetër dhe drurët me zgavra gjatë të gjitha operacioneve pyjore (shfrytëzime, rrallime, pastrime). Grupet e drurëve të vjetër janë veçanërisht të vlefshëm.

- Aty ku është e mundur përpiquini të rrisni larminë e llojeve pyjore dhe strukturës së pyjeve. Ku është e mundur përdorni lloje vendase.

- Ruani drurët fletorë në pyjet halore. Drurët fletorë sigurojnë ushqim dhe strehim.

- Rrisni prodhimin e ushqimit për lakuriqët duke ruajtur habitatet e rëndësishme: pyjet në ligatina, pyjet buzë lumenjve, çeltirat dhe pyjet skajore.

- Kufizoni përdorimin e pesticideve në pyje.

- Evitoni kullimin e tokave pyjore. Krijimi i ligatinave të vogla dhe pellgjeve ndihmon lakuriqët. Përmbytjet dhe stuhitë mund të shkaktojnë drurë të tharë dhe një strukturë pyjore të larmishme.

- Kullotat gjysmë të hapura janë shpesh një habitat i rëndësishëm. Në ditët e sotme kullotja është larguar dhe këto zona po pushtohen nga pylli. Është e rëndësishme të ruhen disa zona me strukturë gjysmë të hapur dhe larmi lulesh. Mos e zini gjithë peizazhin me plantacione monokulturë.

- Kullotja e lopëve apo barngrënësve të tjerë të mëdhenj krijon një larmi pyjesh gjysmë të hapur që janë shumë të vlefshëm si habitat ushqimi për lakuriqët e natës. Megjithatë, kullotja e tepërt mund të shkatërrojë të gjithë nën pyllin.

- Evitoni krijimin e zonave të mëdha me prerje rrah.

- Identifikoni brezin e ardhëm të drurëve për lakuriqët dhe mos i prekni ato gjatë shfrytëzimit.

- Evitoni prerjen e drurëve që janë pranë zgavrave, aty mund të ketë lakuriqë nate që strehohen.

### TË TJERA

- Godinat dhe vendet e nëndheshme si shpellat apo minierat mund të sigurojnë vende të rëndësishme strehimi për lakuriqët. Sigurohuni që këto nuk ndikohen nga operacionet pyjore.



L. Cistrone